



KONFERENCA E PARË, 15.06.2017


“SHËNDETI I GJIMNAZISTËVE DHE STUDIME TË INTEGRUARA TË FUSHAVE BIOMJEKËSORE”

SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE “IBRAHIM KODRA”, DURRËS

LËNDA: BIOLOGJI

PROJEKT Nr. 7

Tema: “Infarkti i miokardit”




Punoi: Mario PËRGJEGJI
Ledio DEDA
Juna BRAHIMAJ
Francis TOLA
Eljo TODA


Udhëhoqi: Dr. Laura GJYLI

Durrës, 2017

Objektivat e Realizuara




- Anatomia e zemrës;
- Funksonet e zemrës;
- Presioni i gjakut;
- Infarkti i Miokardit;
- Tipet e Infarktit të Miokardit;
- Simptomat dhe shenjat e Infarktit të Miokardit;
- Shkaqet kryesore të këtij infarkti;
- Metodat për diagnostikimin e infarktit të miokardit;
- Statistikat më të fundit rreth kësaj sëmundjeje në Europë dhe më gjerë;
- Këshilla për të evituar infarktin e miokardit;



Anatomia e zemrës

Zemra është **organi kryesor** i sistemit të qarkullimit të gjakut. Në një këndvështrim të përgjithshëm, pjesët përbërëse të zemrës mund të përfaqësohen nga:

- 1) Perikardiumi** (membranat dhe muret e zemrës). Këtu përfshihen:
 - a) *Epikardiumi*;
 - b) *Miokardiumi*;
 - c) *Endokardiumi*.
- 2) Dhomat e zemrës** (zgavrat e brendshme), të cilat janë:
 - a) *Atrium sinistrum*;
 - b) *Atrium dextrum*;
 - c) *Ventriculum sinistrum*;
 - d) *Ventriculum dextrum*.
- 3) Valvulat e zemrës** (bëjnë lidhjen mes dhomave):
 - a) *Valvula sinatriale*;
 - b) *Valvula atrioventriculare*.
- 4) Enët hyrëse dhe dalëse**, ndër të cilat veçohen: aorta, arteria dhe vena mushkërore, vena *cava* etj.




Funksionet e zemrës

Funksioni kryesor i zemrës është **pompimi i gjakut** në të gjithë indet e organizmit. Kjo bëhet përmes qarkullimit të madh dhe të vogël të gjakut.

Qarkullimi i madh i gjakut fillon në *ventriculum sinistrum* dhe përfundon në *atrium dextrum*. Gjatë këtij procesi realizohet furnizimi me **oksigen** i të gjitha indeve të organizmit.

Pas kësaj, gjaku pasurohet me **dioksid karboni**, pasi e ka marrë atë nga indet, me anë të **difuzionit**. Kur gjaku rikthehet në zemër, fillon **qarkullimi i vogël i gjakut**, i cili starton në *ventriculum dextrum* dhe përfundon në *atrium sinistrum*.

Gjatë qarkullimit të vogël, gjaku shkon në mushkëri për të lënë dioksidin e karbonit dhe për t'u furnizuar me oksigjen, në mënyrë që të rifillojë sërish shpërndarjen e O₂ në organizëm.



Presioni i gjakut



Presioni i gjakut konsiston në tkurrjen dhe lëshimin e muskujve të zemrës (sistola dhe diastola).

Presioni sistolik nënkupton presionin që ushtron gjaku në muret arteriale gjatë tkurrjes së zemrës.

Presioni diastolik përfshin presionin që ushtron gjaku në muret arteriale gjatë lëshimit të muskujve të zemrës.

Matja e presionit të gjakut bëhet lehtësisht me anë të aparaturave të posacme.

Vlera e presionit arterial jepet në formën:




Matja e presionit të gjakut

117 tregon presionin sistolik dhe 76 tregon presionin diastolik.


Njësia matëse është mm shtyllë zhivë.

Infarkti i Miokardit

Infarkti i Miokardit, zakonisht i cilësuar si infarkti i zemrës, është një ndër sëmundjet më të rënda të zemrës. Ai shkaktohet kryesisht nga vdekja e një pjese të muskullit të zemrës, për shkak të mosfurnizimit për një kohë të gjatë me oksigjen. Pasojat e këtij infarkti janë tepër të rënda, madje deri në vdekje.



Myocardial infarction



Ndër shkaktarët kryesorë janë arterioskleroza, e cila pengon qarkullimin normal të gjakut, mosfunksionimi i mushkërive, që sjell mungesë të oksigjenit etj.


Ka metoda parandalimi efektive ndaj infarktut të miokardit, duke qenë se shkaktarët e tij njihen mjaft mirë.

Tipet e Infarktit të Miokardit

Sipas studimeve më të fundit, ka 4 lloje të infarktit të miokardit, të cilët përcaktohen nga pasojat që lënë tek pacienti.

Ato janë:

1. MI tipi 1, i cili shoqërohet me bllokim të enëve të gjakut me trombocite;
2. MI tipi 2, i cili shoqërohet me iskemi;
3. MI tipi 3, i cili sjell vdekjen e një pjese të zemrës;
4. MI tipi 4, i cili shoqërohet me angioplasti kornare.



Plaque rupture with thrombus



MI Type 1

Vasospasm or endothelial dysfunction



MI Type 2

Fixed atherosclerosis and supply-demand imbalance



MI Type 2

Supply-demand imbalance alone




MI Type 2

Simptomat dhe shenjat

Për të kuptuar nëse një person rrezikohet nga infarkti i miokardit, duhen patur parasysh disa simptoma tipike dalluese të kësaj sëmundjeje. Ndër to përmenden:

1. Lodhje e vazhdueshme;
2. Dhimbje jo të zakonshme në kraharor;
3. Të ndjerit i pafuqishëm dhe pa energji;
4. Rritje e befasishme e ritmit të zemrës;
5. çrregullim i pulsit, etj.





Ndërkaq, dhimbjet në kraharor kanë këto karakteristika:

- 1) Përsëriten për 30-60 minuta;
- 2) Shoqërohen me dhimbje të tjera në krahun e majtë, shpatullën e majtë etj.
- 3) Dhimbjet janë të forta e të mprehta;
- 4) Dhimbjet shoqërohen në probleme të tretjes.

Shkaktarët e tij

Ndër shkaktarët më të zakonshëm të infarktit të miokardit janë:

- Moshë e lartë;
- Duhanpirja aktive;
- Presioni i lartë i gjakut;
- Diabeti dhe sasia e lartë e kolesterolit;
- Obeziteti;
- Pirja e alkoolit;
- Situata të vazhdueshme stresante;
- Menopauza etj.




Duhet përmendur se infarkti i miokardit mund të jetë i trashëgueshëm, ndaj duhet patur parasysh edhe historia mjekësore e familjes.

Një tjetër faktor kyç është edhe furnizimi i organizmit me oksigjen, pra keqfunksionimi i mushkërive apo rrugëve të traktit respirator.

Diagnostikimi

Metodat më të përdorura për diagnostikimin e infarktit të miokardit në laborator janë:

1. Përdorimi i enzimave që detektojnë praninë ose jo të problemeve me muskulin e zemrës;
2. Niveli i troponinës;
3. Sasia e qelizave të gjakut;
4. Paneli metabolik;
5. Sasia e lipideve në gjak.





Ndërkaq, në mjekësi përdoren dy metoda, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me skanografinë:

1. Elektrokardiografia;
2. Imazheria kardiologjike.



Statistika rreth infarktit

Siç kuptohet dhe nga grafiku, rreziku i prekjes nga infarkti i miokardit rritet me rritjen e moshës. Gjithashtu femrat janë më të rrezikuara se meshkujt.



Në grafikun përbri tregohen tipet e komplikimeve që vijnë nga infarkti i miokardit dhe shpeshinë e tyre. Duket qartë që sëmundjet kardiovaskulare janë shoqëruesit më të zakonshëm të këtij infarkti.

Këshilla për parandalimin e tij

Për të parandaluar infarktin e miokardit duhen patur parasysh shkaktarët e saj. Nisur nga kjo mund të themi se për të pasur një zemër të shëndetshme dhe të fortë duhet të:

- ✓ Rrisim aktivitetin fizik;
- ✓ Shmangim përdorimin e vazhdueshëm të alkoolit apo duhanit;
- ✓ Reduktojmë sasinë e yndyrnave dhe sheqernave që konsumojmë;
- ✓ Të përpiqemi të shmangim situatat stresante dhe të gjejmë mënyra më efektive për t'i kaluar ato;
- ✓ Të bëjmë kontrole të shpeshta të presionit të gjakut.

Duke ndjekur të gjitha këto këshilla, organizmi jonë do të jetë më i mbrojtur nga infarkti i miokardit.



Bibliografia

- https://en.wikipedia.org/wiki/Myocardial_infarction
- www.healthline.com/health/acute-myocardial-infarction
- <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmedhealth/PMHT0021982>
- www.clevelandclinicmeded.com/.../acute-myocardial-infarction/
- www.cvpharmacology.com/.../myocardial%20infarction
- <https://patient.info/health/heart-attack-myocardial-infarction-leaflet>

